



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 391/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, i përbërë nga gjyqtaret: Fejzullah Rexhepi kryesues, Adnan Konushevcu dhe Faton Ademi anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtarit të lart ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me ankesat e kandidatit për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës Sllavko Simiq kandidat për deputet nga subjekti politik G.I Srpska Lista, paraqitur kundër rezultatit përfundimtar të publikuar nga KQZ-ja me datë 29.06.2017, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 01.07.2017, mori këtë:

## V E N D I M

**I. Pranohen** si të bazuara ankesat Anr. 391/2017, Anr 392/2017, Anr 393/2017, Anr 394/2017, Anr 395/2017 dhe Anr 396/2017 të datës 30.06.2017 të Kandidatit për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Sllavko Simiq nga subjekti politik G.I Srpska Lista,

**II. Urdhërohet** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj të gjitha fletëvotimet për të gjitha subjektet politike dhe të gjithë kandidatët të tyre në vendvotimet: 3805b/11R, 1509e/01D, 3403e/01D, 2813b/01D, 2912b/01D, 2622d/01D.

**III. Rezultati** i cili del pas rinumërimit të kutive të votimeve në Venvotimet si në pikën -II- të këtij dispozitivi, të përfshihen në rezultatin përfundimtar.

## A R S Y E T I M

Subjekti politik G.I Srpska Lista me datën 30.06.2017 ka paraqitur në PZAP, ankesat me numër Anr. 391/2017, Anr 392/2017, Anr 393/2017, Anr 394/2017, Anr 395/2017 dhe Anr 396/2017

Paneli i PZAP-it, në bazë të nenit 8.3 të Rregullave dhe Procedurat e PZAP-it, i ka bashkuar ankesat Anr. 391/2017, Anr 392/2017, Anr 393/2017, Anr 394/2017, Anr 395/2017 dhe Anr 396/2017 të datës 30.06.2017, dhe i ka trajtuar si një ankesë të evidentuar me Anr. 391/2017, për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve ankimore, dhe për të gjitha ankesat vendosi me një vendim, për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

Parashtruesi i ankesave thekson se për shkak të gjendjes së gabuar faktike dhe për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave e LZP-së gjatë publikimit të rezultateve përfundimtare gabimisht është vërtetuar gjendja faktike dhe është bërë një lëshim gjatë futjes së rezultateve të sakta për kandidatet e GI Srpska Lista në vendvotimet e shumta. Pretendohet se numri i fituar i votave që kanë fituar kandidatet e GI Srpska Lista nuk janë shënuar në rezultatet përfundimtare, ku për të gjitha kandidatët e GI Srpska Lista janë shënuar 0 vota, në vend që të regjistrohen votat e fituara siç janë regjistruar në FRK.

Komunat ku pretendohet për lëshimet e bëra janë si në vijim:

Mitrovica e Veriut	VV 3805b/11R	(Ankesa Anr. 391)
Obiliq	VV 1509e/01D	(Ankesa Anr.392)
Graçanicë	VV 3403e/01D	(Ankesa Anr.393)
Zubin Potok	VV 2813b/01D	(Ankesa Anr.394)
Zveqan	VV 2912b/01D	(Ankesa Anr.395)
Viti	VV 2622d/01D	(Ankesa Anr.396)

Andaj parashtruesi i ankesave kërkon nga PZAP-i që këto ankesat të pranohen si të bazuara dhe të urdhërohet KQZ-së që të vërtetojë gjendjen e saktë faktike dhe pastaj të publikohen si rezultatet zyrtare ashtu siç janë konstatuar nga procesverbalet dhe FRK-të nga vendvotimet e theksuara më lartë.

Parashtruesi i ankesës si prova materiale bashkangjitur Formularët e Rezultateve të Kandidatëve dhe Formularët e Përputhjes së të dhënave për vendvotimet e lartcekura.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i shqyrtoj pretendimet ankimore dhe materialin zgjedhor e pas vlerësimit të gjithanshëm të tyre gjeti se:

#### **ankesa është e bazuar**

Paneli gjeti se pretendimet ankimore janë të bazuara, pasi që pas shqyrtimit të provave dhe shkresave të lendes, si dhe nga hetimi i bërë në materialin zgjedhor ka konstatuar se ka mospërputhje të rezultateve të shpallura nga KQZ-ja me Formularët e Rezultateve të Kandidatëve dhe Formularit Përfundimtar të Rezultatit, siç rezulton edhe nga provat e ofruara si dëshmi nga vete pala ankuuese, andaj mbi këtë baze dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së, PZAP-i urdhëron KQZ-në, që të bëhet rinumërimi i të gjitha fletëvotimeve për të gjitha subjektet politike dhe të gjithë kandidatët e tyre për vendvotimet: 3805b/11R 1509e/01D 3403e/01D 2813b/01D 2912b/01D, 2622d/01D, ashtu që rezultati i dal nga këto rinumërimet ti bashkëngjitet rezultatit përfundimtar.

Andaj PZAP nga këto arsye, dhe në mbështetje të nenit 117.4 urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimet e lartcekura.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

A nr. 391/2017 më datën 01.07.2017.



**Kryesuesi i Panelit**  
Fejzullah Rexhepi

***Këshillë Juridike:***

*Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve, nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.*